


Tregues statistikore dhe Panorame e tregut te komunikimeve elektronike ne Shqiperi

Sektori i komunikimeve elektronike eshte nje nder sektoret e ekonomise Shqiptare me rritje me te madhe ne vitet e fundit. Gjate vitit 2009, tregu i telekomunicioneve vazhdoi te rritet me ritme te larta. Numri i supermarresve te cilet kane njoftuar AKEP per ofrmin e rrjeteve dhe sherbimeve te komunikimeve elektronike deri ne fund te vitit 2009 ishte 152, ne krahasim me 99 ne fund te vitit 2008. Rritja e tregut ishte e ndjeshme ne telefonine celulare si dhe ne sherbime te Internetit, duke shenuar per here te pare dhe nje rritje te ndjeshme edhe ne telefonine fiks. Te ardhurat totale te supermarresve per vitin 2008 ishin 61 387 milion LEK, qe perben 5.76% of GDP se Shqiperise (1064000 milion LEK). Kater lojtaret kryesore, AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile (tre operatore celular) dhe Albtelecom (operatori fiks incumbent), zoterojne 96% te te ardhurave te gjithe sektorit.

Figura 1. Te ardhurat totale te operatoreve te komunikimeve Elektronike (2008)



Burimi: Te dhenat e bilanceve te operatoreve te derguara ne AKEP


Telefonia celular

Ne sektorin e telefonise celulare jane leshuar kater autorizime individuale (me pare licensa):

- AMC sh.a,
- Vodafone Albania, sh.a
- Eagle Mobile, sh.a
- Mobile 4 Al sh.a

Ne fund te vitit 2009, numri i perdoruesve te telefonise se levizshme vleresohet te kete arritur ne 4.16 milione, e cila perben nje rritje te konsiderueshme me 40 % apo **1.2 milion** perdorues me shume krahasuar me fundvitin 2008. Norma e penetrimit (numri i perdorueve per 100 banore) arriti ne 129%¹, krahasuar me 92% me 1 Korrik 2008, cka eshtë më e madhe se niveli mesatar prej 119% në vendet e BE ne vitin 2008. Rritja e këtij sektori eshtë përshtpjtuar në vitin 2008 dhe 2009 dhe kompania më e re në treg, Eagle Mobile, kishte rreth 600 mijë pajtimtarë në fund të vitit 2009 apo 14% pjese tregu. Rritje ne krahasim me vitin 2008 kane patur edhe dy operatoret e tjere te telefonise se levizshme AMC dhe Vodafone, te cilet respektivisht kane nje rritje ne numrin e perdoruesve me 37% dhe 26%. Ecuria e numrit te perdoruesve te telefonise celulare duke filluar nga viti 2000 paraqitet ne Figuren 2.

Figura 2. Ecuria e numrit te perdoruesve celulare 2000-2009




Burimi: Te dhenat periodike te operatoreve. Viti 2009 vleresime te operatoreve.

¹ Numri i perdorueve celulare i referohet numrit te kartave SIM aktive, dhe normat e larta te perdoruesve per 100 banore shpjegohen nga mbajtja prej nje individi e me shume se 1 karte SIM si dhe prej perdonimit te kartave SIM nga vizitoret ne nje vend.

Te ardhurat totale te tre operatoreve celulare gjate vitit 2009, vleresohen te jene 47.6 miliard lek, e cila perben nje reduktim me 19% ne krahasim me vitin 2008. Renia e te ardhurave ka ardhur si rezultat i renies se te ardhurave te AMC dhe Vodafone Albania, ndersa te ardhurat e Eagle Mobile jane rritur afersisht 6 here, duke rritur pjesen e tregut te Eagle Mobile nga 1% ne vitin 2008, ne 9% ne vitin 2009. Figura e meposhtem paraqet ecurine e te ardhurave te operatoreve celulare ne periudhen 2003-2009.

Figura 3. Te ardhurat e operatoreve celulare (2003-2009)



Burimi: Te dhenat periodike te operatoreve. Viti 2009 vleresime te operatoreve.

Pjesa me e madhe e perdoruesve celulare vazhdojne te jene perdorues te paketave tarifore me parapagim, rreth 94% nivel i cili ka qene i qendrueshem 2 vitet e fundit. Struktura e perdoruesve, me parapagim dhe me kontrate, eshte e ngjashme per te tre operatoret. Pjeset e tregut te operatoreve AMC dhe Vodafone Albania per vitin 2009 jane zvogeluar, pasi Eagle Mobile ka fituar pjesë tregu ne terma te perdoruesve dhe thirrjeve ne nivel afersisht 15%, krahasuar me nivel 4-9% ne vitin 2008.

Rritja e ndjeshme e numrit te perdoruesve celulare vazhdon te jetë ne kontrast me rritjen shume te vogel te numrit te perdorueve te telefonise fikse. Megjithë nje rritje prej 13% te numrit te pajtimatreve te telefonise fikse gjate vitit 2009, numri i tyre deri ne fund vitin 2009 vlersohet te jetë afersisht 363 mijë, apo 11.2% norme penetrimi per banore. Figura dhe tabela e meposhteme paraqesin ecurine e numrit te pajtimatreve te telefonise fikse dhe celulare dhe normat e penterimit per banore ne periudhen 2003-2009.

Figure.4 Perdorues te telefonise Celulare dhe Fiks 2003 – 2009






Figure 5 Penetrimi i telefonise Mobile dhe Fikse 2003 - 2009



Norma e penetrimit te telefonise celulare (numri i perdoruesve per 100 banore) arriti ne 129%², krahasuar me 92% me 1 Korrik 2008, cka është më e madhe se niveli mesatar prej 119% në vendet e BE ne vitin 2008. Ne Figuren II.4 jane paraqitur vlerat e penetrimit te sherbimit te telefonise celulare ne Shqiperi dhe vende te tjera te rajonit, per periudhen 2005-2009, ne te cilen vihet re se zhvillimi eshte i ngjashem me vendet e rajonit, pavec vitit 2009, ku ne Shqiperi eshte vene re rritje me madhe e numrit te perdoruesve celulare se ne vendet e rajonit.

Figure II.4 Penetrimi i telefonise Celulare ne Shqiperi, vendet e rajonit dhe BE 2003 - 2009



Burimi: Cullen International "Supply of services in monitoring regulatory and market developments for electronic communications and information society services in Enlargement Countries" Draft Report III, January 2010.

III. Perdorimi mesatar per perdorues i sherbimeve celulare

Ne vijim jane dhene tabela dhe grafike me te dhena per perdorimin mujor per perdorues celulare. Perdorimi mesatar mujor per perdorues eshte llogaritur sipas thirrjeve dalese (thirrje qe gjenerohen nga një perdorues) dhe thirrjeve hyrese (thirrjet e marra nga një perdorues), te matura ne minuta dhe numer thirrjesh. Keta tregues Jane llogaritur per te

² Numri i perdorueve celulare i referohet numrit te kartave SIM aktive, dhe normat e larta te perdoruesve per 100 banore shpjegohen nga mbajtja prej nje individi e me shume se 1 karte SIM si dhe prej perdorimit te kartave SIM nga vizitoret ne nje vend.

gjithe trafikun e gjeneruara dhe marre gjate vitit pjestuar me numrin mesatar te perdoruesve gjate vitit (mesatarja e numrit ne fund te vitit me fund vitin e meparshem)³. Minutat e perdorimit (Minutes of Usage-MOU) eshte shuma e thirrjeve dalese dhe hyrese, qe tregon se sa minuta ka shpenzuar nje perdorues ne komunikim zanor. Perdorimi mujor i SMS i referohet vetem mesazheve te derguar. Keto te dhena paraqiten ne tabelen e meposhtem per te tre operatoret celulare.

Tabela: 1 Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve celulare 2006-2009

	2006		2007		2008			2009			Ndryshimi 2009/2008 (%)		
	AMC	VF-AL	AMC	VF-AL	AMC	VF-AL	EAGLE	AMC	VF-AL	EAGLE *	AMC	VF-AL	EAGLE
Thirrje dalese ne muaj	24.32	25.73	25.70	31.30	25.10	30.95	22.80	43.77	59.31	65,32	74%	92%	187%
Thirrje hyrese ne muaj	46.29	49.20	46.28	52.09	45.88	50.39	22.38	58.81	74.20	71,71	28%	47%	220%
MOU	70.60	74.92	71.99	83.39	70.97	81.34	45.17	102.58	133.51	137,04	45%	64%	203%
SMS ne muaj	5.99	10.58	7.23	15.21	6.82	15.09	5.40						

*Te dhenat per EM i referohen gjashtemujorit te pare 2009.

Ne gjashtemujorin e pare 2009 dhe ne vitin 2009 ka pasur nje rritje te ndjeshme te komunikimit per perdoruesper te tre operatoret celulare:

- Perdoruesit e AMC kane kryer mesatarisht 44 minuta thirrje dalese dhe 59 minuta hyrese apo 103 minuta komunikim ne muaj. Ky konsum eshte 28-74% me i madh se ne vitin 2008;
- Perdoruesit e Vodafone kane kryer rreth 60 minuta thirrje dalese dhe 74 minuta thirrje hyrese apo 137 minuta komunikim ne muaj. Ky konsum eshte 47-92% me shume se ne vitin 2008;
- Perdoruesit e Eagle Mobile kane rreth 65 minuta thirrje dalese dhe 71 minuta hyrese apo 137 minuta komunikim ne muaj. Ky konsum eshte 187-220% me shume se ne vitin 2008.

Telefonia fikse

Ne baze te te dhenave te Regjistrat te Sipërmarrësve që kanë njofuar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm deri në datën 23.12.2009, rezultojne keta tregues per sipermarresit:


- Rrjete dhe sherbime publike te telefonise fikse: 74

³ Per gjashtemujorin e pare te vitit 2009, treguesit jane llogaritur ne baze te trafikut te kesaj periudhe dhe numrit mesatar te perdoruesve ne fillim dhe ne fund te periudhes gjashtemujore.

- Sherbime te thirrjeve me karte te parapaguar: 18
- Thirrje telefonike me VoIP: 22
- Sherbim tranzitimi te thirrjeve: 23

Ne ndryshim nga vitet e meparshme, numri i pajtimtareve te telefonise fiks ne vitin 2009, shenoj një rritje prej afersisht 13%, duke arritur ne 363 mijë. Rritja e numrit te pajtimtareve te telefonise fiks kryesisht ka ardhur si pasoje e rritjes se numrit te pajtimtareve Albtelecom, i cili ka pasur një rritje te ndjeshme me 35 mijë pajtimtare apo 13% rritje ne krahasim me vitin 2008, apo me vitet e tjera para-ardhese, te cilat jane karakterizuar nga norma shume te vogla rritjeje prej 1-2%. Te dhenat per operatoret alternative nuk jane te plota, por sipas vleresimit te AKEP numri i pajtimtareve te ketyre operatoreve ne fund te vitit 2009, ishte rreth 65 000 pajtimtare.

Figura 4. Ecuria e numrit te pajtimtareve te telefonise fiks 2000-2009



Norma e penetrimit (numri i linjave fiks per 100 banore) ne fund te vitit 2009, vleresohet te jete 11.2%, e cila vazhdon te jete shume me e ulet se ne vendet e rajonit dhe te BE-se. Numri i linjave fiks per 100 familje vleresohet te jete 40-45, apo afersisht 1 lini telefonie fiks per dy familje.

Tregu i telefonise fiks dominohet nga Albtelekom i cili deri ne fund te vitit 2009, kishte 298 mijë pajtimtare ne total (278 mijë Familjare dhe 20 mijë Biznes) qe perben rreth 80% pjese tregu te linjave fiks. Albtelecom zoteron pjese tregu mbi 80% te thirrjeve dhe ne te ardhura per sektorin e telefonise fiks. Thirrjet dalese te perdorueve te Albtelecom jane kryesisht thirrje lokale, 80% e tyre, ndersa thirrjet nderkombetare zene afersisht 10%. Ne gjashtemujorin e pare te vitit 2009, eshte vene re një rritje e ndjeshme e trafikut te thirrjeve kombetare brenda rrjetit Albtelecom, dhe renie e trafikut lokal, e cila vleresohet te kete ardhur per shkak te procesit te ribalancimit te tarifave te Albtelecom.

Operatoret alternative kane zgjeruar zonat e tyre te operimit dhe jane te perqendruar kryesisht ne zonat me urbane dhe zonat rurale ne afersi te qyteteve. Struktura dhe niveli i tarifave te ketyre operatoreve eshte i ngashme me ato te Albtelecom. Nje numer

operatorësh alternative ofrojnë njëkohësisht shërbime te telefonisë fiksë, akses ne Internet dhe TV.

Interneti

Deri ne fund te vitit 2009, janë rreth 90 sipërmarrës që kanë njoftuar AKEP per ofrimin e shërbimit të aksesit në Internet. Gjate vitit 2009, ofrimi i shërbimeve te Internetit ne brez te gjere (broadband) vazhdoi rritjen e ndjeshme te numrit te pajtimtareve dhe rritjen e numrit te ofertave dhe reduktimin e tarifave. Sipas të dhënave më të fundit nga operatoret dhe vlerësimet e AKEP numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjërë është rreth 80 mijë apo afersisht 10% e familjeve, ndersa janë rreth 8000 pajtimtarë biznesi. Bazuar në këto të dhëna, numri i linjave broadband per 100 banore është rreth 2.5. Teknologjia kryesore është ADSL dhe operatori kryesor është Albtelecom, i cili ka qene shume aktiv ne shërbimet e aksesit ne Internet, nepermjet investimeve ne rrjetin lokal per te mundesar ofrimin e shërbimit broadband nepermjet ADSL dhe reduktimit te tarifave per kete shërbim. Numri i pajtimtarve (lidhjeve) broadband nepermjet ADSL te Albtelecom, deri ne fund te vitit 2009, ishte afersisht 52 mijë (48 mijë familjarë dhe 4 mijë biznes), cka perben një rritje te konsiderueshme ne krahasim me Korrikun 2008, kur numri i tyre ishte rreth 1400.

Rritje te konsiderueshme vleresohej te kene pasur edhe operatoret alternative, te cilet ofrojnë akses broadband ne Internet nepermjet infrastrukturës se tyre me shpejtesi te larta dhe me teknologji ADSL2+, fiber optike dhe linja te dedikuara. Deri ne fund te vitit 2009, numri i pajtimtareve (lidhjeve) broadband te operatoreve alternative vleresohej te jete rreth 20 mijë.

Shpejtesia e aksesit ne Internet me brez te gjere varion nga 256 kbps deri ne 3 Mbps, dhe shpejtesi me te larta per perdorues biznesi te cilet mund te perfitojne akses me linje te dedikuar apo fiber optik.

Ne kete periudhe edhe operatoret celulare kane qene shume aktive ne ofrimin e shërbimeve te internetit nepermjet aparatave celulare dhe kartave modem per PC, duke ofruar reduktime te ndjeshem te tarifave te ketij shërbimi per perdorues me kontrate dhe me parapagim. Deri ne fund te vitit 2009, numri i pajtimtareve celulare (me kontrate dhe me parapagim) qe kane akses ne Internet nepermjet aparatit celular eshte rreth 785 mijë dhe nepermjet kartave modem me PC(Lap Top) eshte rreth 4 mijë. Numri i perdoruesve te biznesit ne te dy keto forma te aksesit ne Internet eshte rreth 60 mijë.

Aksesi në Internet me Dial Up ka ardhur në rënien si pasojë e përdorimit të aksesit me bandë të gjërë, dhe në fund të viti 2009, ishin rreth 14 mijë përdorues të Albtelecom krahasuar me 25 mijë ne vitet e meparshme.